



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I QARKUT ELBASAN**  
**DREJTORIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK, PROJEKTEVE, KULTURËS, TURIZMIT**  
**PËRKUJDESIT SOCIAL DHE SHËRBIMEVE JURIDIKE**

Nr. 167 Prot.

Elbasan, më 04.03 2026

**URDHËR**

Nr 59 , Datë 04 .03.2026

**“PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT MODEL TË TRANSPARENCËS PËR KËSHILLIN  
E QARKUT ELBASAN”**

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, nenit 6 të ligjit Nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, Urdhërit Nr.281, datë 30.12.2025 “Për miratimin e Programit Model të Transparencës për Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore” të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjes së të Dhënave Personale, si dhe Urdhërit Nr.26, datë 02.02.2026 të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Elbasan “Për Ngritjen e Komisionit për Hartimin e Programit Model të Transparencës për Këshillin e Qarkut Elbasan”,

**URDHËROJ:**

1. Miratimin e Programit Model të Transparencës për Këshillin e Qarkut Elbasan, i hartuar nga komisioni i ngritur për këtë qëllim.
2. Ngarkohet Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik, Projekteve, Kulturës, Turizmit, Përkujdesit Social dhe Shërbimeve Juridike për zbatimin e këtij urdhëri si dhe komisioni i ngritur për hartimin e këtij programi.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

